



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.379, datë 31.08.2022

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME
KURBIN SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e 567 përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 31.08.2022 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kurbin sh.a.",

Vëren se:

1. Ujësjetllës Kanalizime Kurbin me shkresën nr.246 prot., datë 15.08.2022, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit - grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit - largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Kurbin në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria UK Kurbin ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 30 212 banorë të Bashkisë Kurbin për tre njësitë administrative: Laç, Mamurras, Milot.
- b) Drejtuesi ligjor z. Drilon Aliu është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë.
- c) Drejtuese teknike znj. Junilda Elezi është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i inxhinierisë së Ndërtimit, dega Inxhinieri Hidroteknikë në vitin 2007 dhe ka mbi 5 vite përvojë në profesion.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Kurbin, të:

- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (*ligji nr. 9121*) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Kurbin është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kurbin sh.a me (NUIS K07628310A), në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
2. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kurbin sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues Ligjor – Drilon Aliu
 - b) Drejtues Teknik – Junilda Elezi

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kurbin sh.a është Bashkia Kurbin.

Njësitë administrative: Laç
 Mamurras
 Milot

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kurbin sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Teknike Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Kurbin sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani